



Pranuar / Dostignut Prilipenja/Prilidate Received/Receivedity	20.04.2022	2. viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKOPSHTICK 2272/2022	115
№ Prilipi Prilip No	Shkup e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.260/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2461/2021, me numër A.nr.2462/2021 dhe A.nr.2463/2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, për shqyrtimin e ankesës së ankuesit të datës 18.08.2021 me numër A.nr.737/2021 të parashtruar nga grup ankuesit dhe [redacted] përmes postës së Kosovës të datës 16.08.2021 me numër R1761807 nga përfaqësuesja e autorizuar avokatja [redacted] në Komunë të Gjilanit, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.737/2021, e datës 18.08.2021, e parashtruar nga grup ankuesish:

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Policinë e Kosovës, sipas kontratës së punës të datës 19.08.2014 në pozitë Zyrtare e arkivi”, në Sektorin Rajonal për Resurse në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Gjilan, kurse ankuesit [redacted] dhe [redacted] të punësuar në Policinë e Kosovës, sipas kontratës së punës të datës 04.08.2014 në pozitë :”Radio komunikues dhe baza e të dhënave”, në Stacionin/ Sektorin i Operativës Rajonale në Gjilan, të cilën përmes përfaqësueses së autorizuar avokates [redacted] me datë 02.07.2021 kanë parashtruar kërkesë tek Komisioni i ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme në Policinë e Kosovës, për realizimin e shpërblimeve të një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt në funde vitit si dhe shujtën ditore për vitin 2018,2019 dhe 2020, të cilët me datë 07.07.2021 kanë pranua përgjigje nga Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë, të cilën përgjigje e kanë pranuar me datës 14.07.2021 dhe kundër përgjigjes me datë 14.07.2021 i drejtohen me ankesë Drejtorisë së

Përgjithshme në Policinë e Kosovës, lidhur me mos aprovimin e kërkesës së tyre të datës 02.07.2021.

Ankuesit kundër heshtjes administrative sipas kërkesës së datës 14.07.2021, me datë 18.08.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokoli 4271/2021 me numër të regjistruar A.nr.737/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimor për njohjen e kompensimit e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit për periudhën 2018,20189 dhe 2020 konform nenit 29 paragrafi.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës si dhe për njohjen e shpërblimit për shujtën ditore konform nenit 29 paragrafin 1 të njëjtit udhëzim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.08.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Policia e Kosovës. Këshilli me datë 25.08.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës prej 1/26 faqe.

Me datë 05.10.2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka njoftuar ankuesin lidhur me mos funksionimin e Këshillit për shkak se Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e datës 30.06.2021 i ka shkarkuar pesë (5) anëtarët e Këshillit dhe kjo e ka bërë të pa mundur vendosjen e ankesës së ankuesve, të cilët janë udhëzuar që të vazhdojnë me procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për konfliktin Administrativ.

Ankuesit pasi e kanë pranuar njoftimin e datës 05.10.2021 kanë ushtruar kërkesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, i cili me datë 17.03.2021 ka nxjerrë Aktgjykimet me numër A.nr.2461/2021, me numër A.nr.2462/2021 dhe A.nr.2463/2021, për ankuesit dhe të cilët Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ka pranuar me datë 22.03.2022 me numër protokoli 1501/2022, të regjistruara me numër A.nr.256/2022, A.nr.258/2022 dhe A.nr.260/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroj këto prova: Aktgjykimet me numër A.nr.2461/2021, me numër A.nr.2462/2021 dhe A.nr.2463/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokoli 4271/2021 të regjistruar me numër A.nr.737/2021/2021 të datës 18.08.2021 e parashtruar përmes përfaqësueses së autorizuar avokates përmes postës së Kosovës të datës 16.08.2021 me numër R1761807; Përgjigje në ankesë e datës 25.08.2021 nr. Protokoli 4396/2021 prej 1/26 faqe; Kërkesa e Këshillit për përgjigje ne ankesë e datës 18.08.2021; kontratës së punës të datës 19.08.2014; kontratës së punës të datës 04.08.2014 ; të dhënat për shpërblime jubilarë e datë 20.08.2021 , sipas listës s e pagave nga data 01.12.20219 deri me datës 31.12.2019 në muajin shkurt 2016 për ankuesin dhe ankuesir

Përgjigje në Kërkesë për shpërblimin e një page mujore si dhe shujtës ditore të datë 7.07.2021; Kërkesë e datës 02.07.2021; Autorizimi i datës 01.01.2021 nga përfaqësuesja e avokates; Autorizimi i datës 30.06.2021 nga përfaqësuesja e avokates; Autorizimi i datës 01.07.2021 nga përfaqësuesja e avokates.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] dhe [redacted] është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht kontratës së punës e datës 19.08.2014 është konstatuar se ankuesja [redacted] ka pozitën "Zyrtare e arkivit", në Sektorin Rajonal për Resurse në Njësinë Burimeve Njerëzore në Gjilan, konform nenit 3 paragrafit 5 të Ligjit Nr.03/149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatuar ky ligji, stafi civil në Policinë e Kosovës i është nënshtruar për veç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave ligjore të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Kontratës së punës të datës 04.08.2014 është konstatuar se ankuesit [redacted] dhe [redacted] kontratës së punës të datës 04.08.2014 në pozitë: "Radio komunikues dhe baza e të dhënave", në Stacionin/ Sektorin i Operativës Rajonale në Gjilan. Ndërsa bazuar në deklarinimin e statusit të zyrtarit publik i konfirmuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Kolegji ka gjetur se pozita Radio komunikues hyn në kategorinë e pozitave të nëpunësve civil.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë së ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 01.01.2021, me datë 30.06.2021 dhe të datës 01.07.2021 i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, për kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe pagës së trembëdhjetë duke filluar nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Drejtori për Personel dhe Administratë i Policisë së Kosovës, me datë 02.07.2021, në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 07.07.2021 ka njoftuar të njëjtin së refuzohet kërkesa sa i për këtë pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore ndërsa sa i për këtë pagesës së pagës jubilarë kjo pagesë është kryer nga Policia e Kosovës në muajin maj 2014 për 10 vite përvojë pune. Pas kësaj përgjigje, ankuesi me datë 14.07.2022 paraqet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës po me bazë të njëjtë ankimore respektivisht kërkon që ti njihet e drejta e kompensimit të shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë dhe pagës jubilarë prej viti 2018, deri e ditën e parashtrimit të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: ... 2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione..., 3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërtime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe

teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e rdekjes, dhe beneficionet e pensionit; 4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagesë shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe beneficionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtaret policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, prej vitit 2018 e deri e ditën e parashtrimt të ankesës duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, kurse me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Neni 20 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar kompensimet e nëpunësve civil përtej pagës, duke paraparë se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit; 8 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës; 2.2. shpenzimet e shkaktuara me rastin e shfrytëzimit të automjetit personal për punë zyrtare; 2.3. shpenzimet e shkaktuara gjatë punës në terren; 2.4. shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se stafi civil në Policinë e Kosovës, mund të realizoj vetëm kompensimet përtej pagës të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më datë 09.07.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë sa nuk cenojnë pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera,



Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke i'u referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.260/2022.

Zyler Millaku -GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar avokates
- Gjykatës Themelore-Prishtinë Gjyqtarës
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

